



NOTARIAL CERTIFICATE

*within the meaning of Article 52(2) of the Act on the notarial profession
(Wet op het notarisambt)*

Seen for legalisation of the signature on the attached document (the "Document") of:

Zoya Georgieva Gyurova, born in Gotse Delchev, Bulgaria, on the 17th day of October 1988
(the "Signatory"),

by me: N.C. van Smaalen, civil law notary in Amsterdam, the Netherlands
on: the 9th day of October 2025
in: Amsterdam, the Netherlands

A handwritten signature in black ink, consisting of several fluid, overlapping strokes.



This notarial certificate is strictly limited to the legalisation of the signature of the Signatory. The Document has not been reviewed for the purpose of issuing this notarial certificate.

No view is expressed to the authority of the Signatory to represent the in the Document mentioned company, and no view is expressed as to the contents of the Document, nor as to the correctness, completeness, validity or enforceability thereof.

This notarial certificate shall be governed by and construed in accordance with the laws of the Netherlands. Any dispute arising in connection with this notarial certificate shall be submitted to the exclusive jurisdiction of the competent court in Amsterdam.

APOSTILLE

(Convention de La Haye du 5 octobre 1961)

1. Country: THE NETHERLANDS
This public document
2. has been signed by **mr. N.C. van Smaalen**
3. acting in the capacity of notary at Amsterdam
4. bears the seal/stamp of aforesaid notary

Certified

5. in Amsterdam
6. on 10-10-2025
7. by the registrar of the district court of Amsterdam
8. no. 25179

9. Seal/stamp:

10. Signature:

F. Silva Pereira



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'F. Silva Pereira', is written over the printed name. The signature is stylized and includes a long horizontal stroke at the end.

**INCORPORATION ACT AND ARTICLES
OF ASSOCIATION OF THE LIMITED
LIABILITY COMPANY "ADRIAVOLT
ECOPOWER" SHPK**

Pursuant to Law No. 9901, dated 14.04.2008, 'On Traders and Commercial Companies,' as amended, and Law No. 9723, dated 03.05.2007, 'On Business Registration,' as amended, the company's operations shall be organized and managed in accordance with the provisions of this Statute.

Article 1 - Legal Basis

The Company shall carry out its activity in accordance with these Articles of Association and Albanian legislation.

Article 2 – Shareholders

2.1 The shareholder of the company is:

- Continental Properties Development B.V., CCI number 98361848, with registered office at Strawinskyiaan 1431, 1077XX Amsterdam, the Netherlands, owning 100% of the capital.

Article 3 – Legal form

The Company shall take the form of a "limited liability company" or SHPK. However, it may be transformed into

**AKT THEMELIMI DHE STATUT I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR
"ADRIAVOLT ECOPOWER" SHPK**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", - i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" – i ndryshuar, veprimtaria e shoqërisë do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti.

Neni 1 - Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin dhe legjislacionin shqiptar.

Neni 2 - Ortakët

2.1 Ortak i shoqërisë është:

- Continental Properties Development B.V. me nr. regjistrimi 98361848, me seli në adresën: Strawinskyiaan 1431, 1077XX Amsterdam, Holandë zotërues i 100% të kapitalit të shoqërisë;

Neni 3 - Forma ligjore

Shoqëria ka formën e "shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar" ose "SHPK". Megjithatë, ajo mund të shndërrohet në një

another legal form in accordance with the applicable Albanian legislation.

Article 4 – Duration

The Company shall have an indefinite duration, beginning from its registration with the National Business Center (NBC).

Article 5 – Registered Office

5.1 The registered office of the Company shall be at the address: Rruga Seman i ri, Zona Kadastrale Nr. 3301, Nr. i Pasurise: 3, Fier, Shqiperi.

5.2 The Company may establish branches and/or representative offices, within and outside the territory of the Republic of Albania, and may also participate in other Albanian and/or foreign companies, whether existing or to be established in the future.

Article 6 – Company documents

6.1 All documents, order forms, or any other correspondence issued by the Company, its branches or representative offices, whether through paper-based or electronic means, and addressed to third parties, must include, in addition to the Company's name, the following information:

a) the unique identification number;

formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4 - Kohëzgjatja e veprimitarisë

Afati i veprimitarisë së Shoqërisë është i pacaktuar. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 5 - Selia

5.1 Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Rruga Seman i ri, Zona Kadastrale Nr. 3301, Nr. i Pasurise: 3, Fier, Shqiperi.

5.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

Neni 6 - Dokumentet e shoqërisë

6.1 Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë, përveç emrit të shoqërisë edhe të dhënat e mëposhtme:

b) the legal form of the Company;
c) the location of its registered office and principal place of business;
ç) information indicating if the Company is in liquidation;
d) the amount of the registered capital of the Company and the amount of capital that has been paid in.

6.2 If the Company has a website, this information must also be published there.

Article 7 – Object of Activity

7.1 The object of the Company's activity shall be:

➤ Provision of real estate services, intermediation, purchase and sale of immovable properties, leasing/subleasing of immovable assets, etc.; The Company will engage in wholesale and retail trade of photovoltaic/wind power plants/panels. Provision of consultancy and technical assistance for the design, study, maintenance, supervision, testing, repair, and production of electrical, photovoltaic, wind equipment, and any other auxiliary materials of the electrical system and network. Import-export of materials,

a) *numrin unik të identifikimit;*
b) *formën ligjore të shoqërisë;*
c) *vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;*
ç) *të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;*
d) *vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit;*

6.2 Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

Neni 7 - Objekti i veprimtarisë

7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

➤ Ofrimi i shërbimeve imobiliare, ndermjetësim, shit-blerje të pronave të paluajtshme, dhënie me qira/nën qira të pasurive të paluajtshme etj; Shoqëria do të kryejë aktivitetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë, impianteve/paneleve fotovoltaike/eulike. Ofrimi i konsulencës dhe asistencës teknike për projektimin, studimin, mirëmbajtjen, mbikëqyrje, kolaudim, riparimin, prodhimin e pajisjeve elektrike, fotovoltaike, eulike dhe të çdo materiali tjetër ndihmës të sistemit dhe rrjetit elektrik.

machinery, equipment, and various electrical, household electrical, electronic devices, thermal systems/plants, energy management systems, lighting systems, telecommunication systems, as well as other similar plants intended for civil and industrial facilities. Wholesale and retail sales, both domestically and abroad, of electricity and various electrical/photovoltaic and wind materials and their equipment, including all elements of alternative energy plants. The company's services consist of, but are not limited to, providing consultancy in the field of marketing, including promotion, advertising, customer service, differentiation, segmentation, direct sales, online marketing, marketing tactics, and public relations. Construction of infrastructure and ancillary works for the development, production, trading, exploitation, operation, maintenance, distribution, and transmission of electricity from renewable photovoltaic sources.

Import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme elektrike, elektroshtëpiake, elektronike, sistemeve /impianteve termike, sisteme për mirëmenaxhimin e energjisë, sisteme ndriçimi, të telekomunikacionit si dhe impianteve të tjera të ngjashme të destinuara për objekte civile dhe industriale. Shitja me shumicë dhe pakicë brenda dhe jashtë vendit të energjisë elektrike, dhe të materialeve të ndryshme elektrike/fotovoltaike e eulike dhe pajisjeve të tyre, duke përfshirë të gjitha elementet e impianteve të energjisë alternative. Shërbimet e shoqërisë konsistojnë por pa u kufizuar në ofrimin e konsulencës në fushën e marketingut nisur nga promovimi, reklamimi, shërbimi ndaj klientit, diferencimi, segmentimi, shitje direkte, marketing online, taktikat e marketingut, marrëdhëniet me publikun. Ndërtimi i infrastrukturës dhe veprave ndihmëse për zhvillimin, prodhimin, tregtimin,

7.2 The Company may carry out any other activity permitted under the applicable legislation of the Republic of Albania.

7.3 The object of activity of the Company may be amended or extended by decision of the Assembly of Shareholders.

Article 8 – Share Capital

8.1 The share capital of the Company is ALL 5,000,000 (five million).

8.2 The capital consists of 1 (one) quota with a nominal value of ALL 5,000,000 (five million), which is held by the shareholder of the Company as established in Article 2.

Article 9 – Transfer of Capital Shares

9.1 The shares of the share capital are freely transferable between the shareholders. The share capital is also freely transferable in cases of inheritance, division of property between spouses, or between ancestors and descendants.

9.2 The shares of the share capital are freely transferable to third parties,

shfrytëzimin, operimin, mirëmbajtjen, shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshem fotovoltaike.

7.2 Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

7.3 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

Neni 8 - Kapitali themeltar

8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 5,000,000 (pesë milionë).

8.2 Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuota me vlerë nominale ALL 5,000,000 (pesë milionë) dhe zotërohet nga ortaku i shoqërisë siç përcaktohet në Nenin 2.

Neni 9 - Transferimi i pjesëve të kapitalit

9.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rast trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.

whether Albanian or foreign entities, natural or legal persons.

- 9.3** The capital share sale agreement may impose restrictions regarding the resale of shares, including the selling shareholder's right of first refusal.

Article 10 – Increase/Reduction of Share Capital

- 10.1** The increase and reduction of the Company's share capital may be carried out by decision of the Assembly of Shareholders and in accordance with the applicable legal requirements.
- 10.2** Upon simple request of the Administrator, the shareholders may unanimously, and in proportion to the quotas they hold, meet the financial needs of the Company through capital increases or shareholder financing (whether interest-bearing or not), in compliance with banking transparency rules and other fiscal requirements. The reimbursement of such contributions or shareholder financing may be decided by the shareholders, and likewise, such

9.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët, qofshin këta subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë.

9.3 Akti i shitjes së kuotave të kapitalit mund të vendosë kufizime në lidhje me rishitjen e kuotave, përfshirë këtu të drejtën e parablerjes së saj nga ortaku shitës.

Neni 10 - Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit

- 10.1** Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së ortakëve si dhe në përputhje me kërkesat ligjore.
- 10.2** Ortakët, me kërkesë të thjeshtë të administratorit, në mënyrë unanime dhe në përpjesëtim të drejtë të kuotave që posedojnë, mund të përmbushin nevojat financiare të shoqërisë nëpërmjet rritjes së kapitalit ose financimeve (qofshin këto me fitim/interes ose jo), duke respektuar normat e transparencës bankare dhe kërkesat të tjera me karakter fiskal. Rimbursimi i derdhjeve dhe i financimeve të ortakëve mund të bëhet me vendim të ortakëve, siç, me të njëjtat modalitete mund të destinohen për

funds may be allocated to cover potential operating losses.

Article 11 – Shareholders’ Assembly

11.1 For as long as the Company has only one Shareholder, the powers of the Shareholders’ Assembly shall be exercised by the Sole Shareholder.

11.2 The Shareholders’ Assembly has the following main powers:

- o to amend the provisions of the Statute;
- o to increase or reduce the share capital;
- o to appoint and replace the Administrator, liquidators, and the statutory auditor;
- o to approve the remuneration of the Administrator, liquidators, and the statutory auditor;
- o to approve the annual accounts (balance sheet);
- o to change the legal form of the Company;
- o to dissolve the Company and decide on its early liquidation and any other powers provided by the applicable Albanian commercial legislation.

11.3 The Shareholders’ Assembly shall convene at least once a year and

mbulimin e humbjeve eventuale ushtrimore.

Neni 11 - Asambleja e Ortakëve

11.1 Për aq kohë sa shoqëria do të ketë vetëm një Ortak, kompetencat e Asamblesë së Ortakëve, do të ushtrohen nga Ortaku i Vetëm.

11.2 Asambleja e ortakëve ka këto kompetenca kryesore:

- *ndryshimi i dispozitave të statutit,*
- *zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit,*
- *emërimi dhe ndryshimi i administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,*
- *miratimi i shpërblimeve të administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,*
- *miratimi i llogarive vjetore(bilancit),*
- *ndryshimi i formës ligjore të shoqërisë,*
- *mbyllja dhe shpërndarja e parakohshme shoqërisë si dhe të tjera të përcaktuara në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi.*

11.3 Asambleja e ortakëve mbledhet të paktën një herë në vit dhe sa herë që duhet të vendosë për çështje të kompetencës së saj. Mbledhja mund

whenever necessary to decide on matters within its competence. The meeting may also be held via video conference.

11.4 The Assembly shall be convened by the Administrator or by shareholders representing at least 5% of the share capital. The Assembly shall be called by written notice sent to the shareholders at least seven days prior to the date of the meeting. The notice may also be sent via email but must in any case contain the date, time, place, and agenda of the meeting.

11.5 Shareholders may be represented at the meeting by other persons, on the basis of a proxy previously granted by them.

Article 12 – Decision-Making

12.1 In cases where decisions require a simple majority, the Shareholders' Assembly may validly decide only if shareholders holding more than 30% of the Company's share capital and having voting rights are present.

12.2 In cases where decisions require a qualified majority, the Shareholders' Assembly may validly decide only if shareholders holding more than 50%

të realizohet edhe nëpërmjet video-konferencës.

11.4 Mbledhja e Asamblesë thirret nga Administratori ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar. Asambleja thirret me anë të një njoftimi me shkrim që u dërgohet ortakëve të paktën shtatë ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi mund të dërgohet edhe nëpërmjet postës elektronike por në çdo rast duhet të përmbajë ditën, orën, vendin si dhe rendin e ditës me çështjet që do të trajtohen.

11.5 Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje nga persona të tjerë, bazuar në një prokurë të lëshuar paraprakisht, prej tyre.

Neni 12 - Vendimmarrja

12.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit të shoqërisë.

12.2 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse

of the Company's share capital and having voting rights are present.

12.3 The Shareholders' Assembly shall decide by a 75% majority of the represented capital (as referred to in point 12.2 above) in cases involving amendments to the Statute, increase or reduction of share capital, profit distribution, reorganization, and dissolution of the Company. In other cases, decisions shall be taken by more than 50% of the votes of the shareholders participating in the meeting.

12.4 All decisions of the Assembly must be recorded in minutes, which shall indicate the date, place, agenda, name of the chairperson and the minute-taker, the key matters discussed, and the decisions taken. The minutes shall be signed by the Chairperson and the Secretary (minute-taker).

Article 13 – Administrator

13.1 The Administrator is appointed for a term of 5 (five) years. The Administrator may be replaced or dismissed from this position by decision of the Shareholders' Assembly. The term is renewable.

marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.

12.3 Asambleja e shoqërisë, vendos me 75% të kapitalit pjesëmarrës (të përfaqësuar nga ortakët), siç parashikohet në pikën 12.2 më sipër, për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në rastet e tjera, asambleja e shoqërisë, vendos me më shumë se 50% të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.

12.4 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në një procesverbal, ku shënohet data, vendi, rendi i ditës, emri i drejtuesit të mbledhjes dhe mbajtësit të procesverbalit, çështjet kryesore dhe vendimet e marra. Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari (mbajtësi i procesverbalit).

Neni 13 - Administratori

13.1 Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Administratori zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.

13.2 The first Administrator of the Company is Mrs. Blerta Gjoni, Albanian citizen, born on 19.11.1986, residing in Durres, Lagjia nr. 5, identified with ID card no. 033133388 and personal number I66119006L.

13.3 The Administrator shall, among other duties, have the right to: manage the day-to-day operations of the Company; represent the Company in relations with third parties; submit proposals and reports to the Shareholders' Assembly regarding the Company's activities; open bank accounts in the name of the Company; as well as exercise other rights granted by law and the Shareholders' Assembly.

13.4 The Administrator may appoint directors, representatives with power of attorney, and general agents for specific acts or categories of acts.

13.5 The Administrator of the Company may not sell and/or purchase immovable property in the name and on behalf of the Company without prior written approval of the Shareholders' Assembly.

13.2 Administratori i parë i shoqërisë është: Znj. Blerta Gjoni, shtetase shqiptare, e dalëllindjes 19.11.1986, banuese në Durres, Lagjia nr. 5, e identifikuar nga letërnjoftimi me nr. 033133388 dhe nr. personal I66119006L.

13.3 Administratori, ndër të tjera, ka të drejtë: të drejtojë veprimtarinë e përditshme të shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë para Asamblesë së ortakëve propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të shoqërisë, si dhe të drejta të tjera të cilat mund t'i njihen nga ligji dhe Asambleja e ortakëve.

13.4 Administratori, mund të emërojë drejtorë, përfaqësues me prokurë dhe të mandatuar të përgjithshëm për veprime të caktuara ose kategori veprimesh.

13.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të shesë dhe/ose blejë pasuri të paluajtshme në emër dhe për llogari të shoqërisë, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim të asamblesë së ortakëve.

Article 14 - Financial Control
The Shareholders' Assembly may appoint

Neni 14 - Kontrolli financiar

one or more statutory auditors who shall be responsible for carrying out the accounting and financial control of the Company.

Article 15 – Financial Year

15.1 The financial year of the Company shall coincide with the calendar year, starting on January 1st and ending on December 31st of each year.

15.2 By way of exception, the first financial year of the Company shall commence on the date of its registration with the Commercial Register of the National Business Center.

Article 16 – Balance Sheet and Dividends

16.1 At the end of the financial year, the Administrator shall take the necessary measures to prepare the balance sheet. The balance sheet shall be submitted to the Shareholders' Assembly for approval, within the legal deadlines.

16.2 The Shareholders' Assembly that approves the annual balance sheet shall decide on the distribution of profit to the shareholders or the creation of legal reserves.

Asambleja e Ortakëve mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të cilët kanë detyrën të kryejnë kontrollin kontabël dhe financiar të shoqërisë.

Neni 15 - Viti financiar

15.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor te çdo viti.

15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 16 - Bilanci dhe Dividendët

16.1 Në fund të vitit ushtrimor, administratori, merr masa për përgatitjen e bilancit.

Bilanci i paraqitet Asamblesë së Ortakëve për miratim, brenda afateve ligjore.

16.2 Asambleja e ortakëve që miraton bilancin vjetor, vendos mbi shpërndarjen e fitimit ortakëve ose krijimin e rezervave ligjore.

Article 17 – Liquidation and Dissolution

The liquidation and dissolution of the Company shall be decided and carried out in accordance with the applicable legal requirements.

Article 18 – Final Provisions

This Statute is drawn up in two originals, in the Albanian and English languages, both having equal legal force.

Neni 17 - Likuidimi dhe prishja

Likuidimi dhe prishja e Shoqërisë vendoset dhe kryhet në përputhje me kërkesat ligjore.

Neni 18 - Dispozita mbyllëse

Ky Statut hartohet në dy ekzemplarë në gjuhën shqipe dhe angleze me fuqi të njëjtë ligjore.



MEMBER
OF THE COMPANY "ADRIAVOLT ECOPOWER" SHPK
ORTAKU I
SHOQËRISË "ADRIAVOLT ECOPOWER" SHPK

Continental Properties Development B.V.

Represented by/përfaqësuar nga
DUTCH TRUST MANAGEMENT B.V.
Represented by/përfaqësuar nga
Z. Gyurova

Date: 07.10.2025



ÇERTIFIKATË NOTERIALE

në kuptimin e Nenit 52(2) të Ligjit mbi profesionin noterial
(Wet op het notarisambt)

U pa për legalizimin e nënshkrimit në dokumentin e bashkangjitur (në vijim: "**Dokumenti**") të:

Zoya Georgieva Gyurova, lindur në Gotse Delchev, Bullgari, më 17 tetor 1988
("Nënshkruesja"),

nga unë: **N.C. van Smalaen**, noter i së drejtës civile në Amsterdam, Mbretëria e Hollandës
më datë: **9 tetor 2025**
në: **Amsterdam, Mbretëria e Hollandës**

(nënshkrim)
(vula e noterit)

Kjo çertifikatë noteriale kufizohet rreptësisht vetëm në legalizimin e nënshkrimit të Nënshkrueses. **Dokumenti** nuk është rishikuar për qëllimin e lëshimit të kësaj çertifikate noteriale.

Nuk jepet asnjë mendim lidhur me **autoritetin e Nënshkrueses** për të përfaqësuar subjektin e përmendur në Dokumentin e lartpërmendur, dhe asnjë mendim nuk jepet për **përmbajtjen e Dokumentit**, as për saktësinë, plotësinë, vlefshmërinë apo zbatueshmërinë e tij.

Kjo çertifikatë noteriale do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Mbretërisë së Hollandës.

Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me këtë çertifikatë noteriale do të i nënshtrohet juridiksionit ekskluziv të gjykatës kompetente në Amsterdam.

Unë, Amantia Gjickondi, përkthyes zyrtar i gjuhës angleze, e çertifikuar nga Ministria e Drejtësisë me çertifikatën nr. 17, datë 31.07.2024, deklaroj me këtë akt se kam përkthyer dokumentin që më është paraqitur nga gjuha angleze në gjuhën shqipe në mënyrë të saktë, me kujdes të duhur dhe nën përgjegjësi ligjore.



RECEIVED
CIVIL
19 11 1963

APOSTILË

(Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961)

1. **Shteti:** HOLLANDË

Ky dokument publik

2. është nënshkruar nga **z. N.C. van Smalaen**
3. duke vepruar në cilësinë e noterit në Amsterdam
4. dhe mban vulën/pullën e noterit të sipërpërmendur

Vërtetohet

6. **Në:** Amsterdam
7. **Më datë:** 10-10-2025
8. **Nga:** regjistruesi i gjykatës së rrethit të Amsterdami
9. **Nr.:** 25179
10. **Vulë/pullë:**


(nënshkrim)

F. Silvia Pereira

(Vula: *Fechtbank Amsterdam*)

Unë, Amantia Gjickondi, përkthyes zyrtar i gjuhës angleze, e certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me certifikatën nr. 17, datë 31.07.2024, deklaroj me këtë akt se kam përkthyer dokumentin që më është paraqitur nga gjuha angleze në gjuhën shqipe në mënyrë të saktë, me kujdes të duhur dhe nën përgjegjësi ligjore.





REZOLUTË E BORDIT TË DREJTORËVE TË SHOQËRISË CONTINENTAL
PROPERTIES DEVELOPMENT B.V.

NËNNSHKRUAR:

DUTCH TRUST MANAGEMENT BV, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas ligjeve të Mbretërisë së Hollandës, me seli të regjistruar në **Strawinskylaan 1431, 1077 XX, Amsterdam, Mbretëria e Hollandës**, e regjistruar në **Dhomën e Tregtisë të Hollandës** me numër **KVK 34203884**, përfaqësuar nga **Znj. Zoya Gyurova** (në vijim do t'i referohet si "DTM").

KURSE:

A. DTM është drejtori i vetëm menaxhues (në vijim do t'i referohet si "Bordi") i Continental Properties Development B.V., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas ligjeve të Mbretërisë së Holandës, me seli të regjistruar në Strawinskylaan 1431, 1077 XX, Amsterdam, e regjistruar në Dhomën e Tregtisë së Amsterdemit me numër CCI 98361848 (në vijim do t'i referohet si "Shoqëria").

B. Shoqëria dëshiron të krijojë "AdriaVolt EcoPower Shpk" (në vijim do t'i referohet si "Shoqëria Bijë"), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në Rrugën Sëman i Ri, Zona Kadastrale Nr. 3301, Nr. i Pasurisë: 3, Fier, Shqipëri, me kapital themeltar prej ALL 5,000,000 (pesë milionë) dhe me administratore Znj. Blerta Gjoni, me numër ID 0311333388 dhe numër personal 166119006L. Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar, dhe veprimtaria e saj do të përfshijë si më poshtë: *"Ofrim të pasurive të paluajtshme, dhënie me qira, nënqira, blerje dhe shitje të pasurive të paluajtshme, marrje/zhvillim ndërtimesh etj.; Shoqëria do të angazhohet në tregtinë me shumicë dhe pakicë të produkteve elektrike/fotovoltaike, pajisjeve të erës dhe materialeve ndihmëse për centralet elektrike/fotovoltaike. Do të ofrohet konsulencë teknike dhe shërbime studimore, mirëmbajtje, mbikëqyrje, testim, riparim dhe prodhim i pajisjeve elektrike, fotovoltaike, dhe pajisjeve të tjera ndihmëse të sistemeve elektrike dhe rrjeteve energjetike. Do të kryhet import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve elektrike, produkteve elektrike të amvisërisë, pajisjeve elektronike, sistemeve termike/energjitike, sistemeve të ndriçimit, sistemeve të telekomunikacionit, si dhe prodhimi dhe tregtimi i pajisjeve të ngjashme për qëllime civile dhe industriale. Shoqëria do të tregtojë në vend dhe jashtë vendit, energjitë elektrike dhe materialet elektrike/fotovoltaike; materialet e energjisë alternative dhe pajisjet e tyre, duke përfshirë të gjitha elementet e centraleve elektrike të energjisë alternative. Shërbimet e kompanisë përfshijnë, por nuk kufizohen në: dhënie konsulence në fushën e marketingut, duke përfshirë promovimin, këshillimin, ndarjen e tregut, shitjet direkte, marketingun online, marrëdhëniet me publikun. Ndërtim infrastrukture dhe punime ndihmëse për zhvillimin, prodhimin, tregtimin, shfrytëzimin, operimin, mirëmbajtjen, shpërndarjen dhe transmetimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme fotovoltaike."*

Unë, Amantia Gjikondi, përkthyes zyrtar i gjuhës angleze, e certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me certifikatën nr. 17, datë 31.07.2024, deklaroj me këtë akt se kam përkthyer dokumentin që më është paraqitur nga gjuha angleze në gjuhën shqipe në mënyrë të saktë, me kujdes të duhur dhe nën përgjegjësi ligjore.





C. Shoqëria bijë mund të angazhohet në çdo veprimtari tjetër të lejuar nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

D. Bordi, që përfaqëson Shoqërinë, dëshiron të autorizojë Znj. Blerta Gjoni si administratore, person fizik, lindur në Shijak, Shqipëri, më 19.11.1986, me numër ID 033133388, numër personal 166119006L, banues në Durrës, Lagjja nr. 5, për të kryer inkuorporimin dhe regjistrimin e Shoqërisë Bijë dhe për të ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm në lidhje me inkuorporimin e përmendur më sipër.

ME KËTË VENDOSËT:

1. Të themelojë Shoqërinë Bijë;
2. Të autorizojë Znj. Blerta Gjoni të kryejë inkuorporimin dhe regjistrimin e Shoqërisë Bijë dhe të ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm në lidhje me inkuorporimin e përmendur më sipër.

PRANDAJ ËSITË NËNSHKRUAR NGA:

(nënshkrimi)

DUTCH TRUST MANAGEMENT B.V.

Titulli: Drejtore

Përfaqësuar nga: Z. Gyurova

Vendi: Amsterdam, Mbretëria e Hollandës

Data: 7 tetor 2025

Unë, Amantia Gjikondi, përkthyes zyrtar i gjuhës angleze, e certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me certifikatën nr. 17, datë 31.07.2024, deklaroj me këtë akt se kam përkthyer dokumentin që më është paraqitur nga gjuha angleze në gjuhën shqipe në mënyrë të saktë, me kujdes të duhur dhe nën përgjegjësi ligjore.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ARDJANA A. MEDIU



V2023050620404540981

DATE 13/10/2025
NR REP 5950

VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 13/10/2025, para meje Notere Ardjana A. Mediu, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Rruga 'Ismail Qemali', Pall Nr.11, Kati Nr.2, 1010, Tiranë, u paraqit personalisht:

PËRKTHYES:

Zj.Amantia Gjikondi, atësia Sazan, amësia Rajmonda, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga "Naim Frashëri", lindur më 02/05/1988, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032182289 dhe nr. personal I85502073J.

Përkthyesja është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkëngjitur, nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë;" në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

Ardjana A. Mediu

